



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 215, Datë 15.12.2020

MBI

**LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 206, DATË
16.12.2019, “MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË PËRKOHSHME TË
TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA ALBGAZ SH.A” PËR
VITIN 2021.**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 13, pika 1; nenit 16, pika 2; neni 17, gërma “e” dhe nenit 33, të Ligjit Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, si dhe nenit 21, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE- s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve nr. 132/9 Prot, datë 11.12.2020, në lidhje me lënien në fuqi të Vendimit të bordit të ERE-s, nr. 60, datë 15.04.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. për vitin 2021”,

Konstatoi se:

- Me Vendimin nr. 60, datë 15.04.2019, bordi i ERE-s vendosi “Miratimin e përkohshëm të tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a prej 28 lek/m³ ose 2.6457 lek/kwh deri më 31.12.2019”.
- Me Vendimin e bordit të ERE Nr. 206, datë 16.12.2019, është miratuar lënia në fuqi e Vendimit të bordit të ERE-s Nr. 60, datë 15.04.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. për vitin 2020”.
- Në kushtet kur shoqëria ALBGAZ sh.a:
 - Nuk ka paraqitur ende aplikim për rishikimin e tarifës së transmetimit për periudhën e ardhshme rregullatore në zbatim të pikës 1, të nenit 21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.
 - Në vijim të paraqitjes së planit të zhvillimit të rrjetit për periudhën 2019–2028, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, nga ana e ERE-s është kërkuar qëndrimi i shoqërisë Albgaz sh.a. në lidhje me zbatueshmërinë e Planit 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit, si pasojë e konstatimeve të ERE mbi planin dhe situatën e krijuar nga gjendja e pandemisë në Republikën e Shqipërisë.
 - Tarifa e shërbimit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëria Albgaz sh.a., i cili ushtrohet konform Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, si dhe Direktivave të

Komunitetit të Energjisë, ku aksesimi në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t'i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

- Shoqëria Albgaz sh.a. nuk ka paraqitur ende Pasqyrat Financiare për vitin 2019, si rrjedhojë edhe e shtyrjes së afatit nga qeveria shqiptare për pasojë të situatës së krijuar nga gjendja e jashtëzakonshme, shkaktuar nga pandemia Covid-19.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e fuqisë juridike të Vendimit Nr. 206, datë 16.12.2019, të bordit të ERE-s, për vitin 2021 deri në miratimin e një tarife mbështetur në aplikimin e shoqërisë Albgaz sh.a.
2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë Albgaz sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e” të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.
3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin fuqinë juridike që nga 01.01.2021.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI